



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 21, datë 09 .04. 2013

PËR

“MIRATIMIN E TREGUESVE EKONOMIKË DHE FINANCIARË TË BASHKISË SË TIRANËS DHE TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËR PERIUdhËN 2014-2016”

Në mbështetje të nenit 32, gërma dh të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, (i ndryshuar); ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), udhëzimeve të Ministrit të Financave nr.9/1, datë 25.02.2013 “Për përgatitjen e buxhetit vendor” dhe nr.8, datë 29.03.2012, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë treguesit ekonomikë dhe financiarë të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2014-2016, sipas lidhjes nr.1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratojë tavanet përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2014 - 2016, sipas programeve dhe për çdo njësi shpenzuese, sipas lidhjes nr. 2 dhe lidhjes nr. 3, pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Investimeve të Huaja, Njësitë Bashkiake dhe të gjitha Institucionet dhe Ndërmarrjet në varësi të Bashkisë së Tiranës, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI